



KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
Prantuar	14.01.2022		
Nj. Org	Numër	Vlera	
01	060/06	64266	



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit
Drenas, më 14.01.2022

Në vështrim të nenit 68, Kreu i IX- Demokracia e Drejtpërdrejtë dhe Mekanizmat e Pjesëmarrjes së Qytetarëve, pika 68.1, 68.2 dhe 68.3 që ka të bëjë me informimin publik dhe konsultim të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 21, 22, 23, 24, 25 dhe 26 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 7 pika 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10 të Rregullores Komunale për Transparencë, Objektivit 4, pika 4.1 të Planit të Veprimit për Përmbushjen e Transparencës Komunale 2019-2023, Komuna e Drenasit ka organizuar tubim me publikun duke raportuar për punën një vjeçare.

Procesverbal i takimit me publikun

Mbledhjen e hapi z. Bekim Dobra duke filluar nga ora 10:00 më 29.12.2021, ku të pranishëm ishin : Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, drejtorë të drejtorive komunale, administratorë të fshatrave, përfaqësues të lagjeve dhe qytetarë të tjerë.



Rend dite: Në këtë tubim me publikun përfaqësuesit e Komunës do të informojnë pjesëmarrësit për aktivitetin e Komunës për punën një vjeçare, gjatë vitit 2021.

Bekim Dobra: I nderuar kryetar i Komunës, z. Ramiz Lladrovci, drejtorë të drejtorive komunale, anëtarë të Kuvendit të Komunës, administratorë të fshatrave, përfaqësues të lagjeve, ju qytetarë.

Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Komuna është e obliguar të mbajë dy tubime me publikun, njëra në gjashtëmujorin e parë të vitit fiskal dhe e dyta në fundvit, kjo që po e mbajmë.

Për këtë tubim, Komuna ka bërë me kohë njoftimin dhe ka publikuar dy javë më herët në ueb faqe të Komunës, në rrjetin social të Komunës si dhe është shpërndarë në mediat online lokale.

Të nderuar të pranishëm,

Ndjejë për obligim të ju njoftojë për rregullat e takimit!

Tubimi me publikun ka karakter informues për pjesëmarrësit, ku përfaqësuesit e Komunës ju njoftojnë për aktivitetet e punës një vjeçare, për të arriturat dhe vëshirësitë, realizimin e projekteve të planifikuara për këtë vit dhe çështje tjera që janë në interes të qytetarëve.

Ftojë kryetarin e Komunës, z. Ramiz Lladrovci të përshëndet takimin.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci - I përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falënderojë për pjesëmarrje në këtë takim. Ndonëse një vit me plot sfida e vonesa në realizim të planifikimeve, të shkaktuar nga pandemia globale e virusit covid-19, ne me të gjitha kapacitetet jemi munduar që të gjitha projektet të cilat kanë qenë të planifikuara të realizohen sipas planifikimit, madje në disa premtime edhe i kemi tejkaluar. Sipas të dhënave preliminare të shpenzimit të buxhetit, jemi afër 90 për qind në shpenzim e mbi 80 për qind vetëm në investime kapitale. Falënderoj të gjithë qytetarët, të cilët na kanë mirëkuptuar e bashkëpunuar në arritjen e qëllimeve tona të përbashkëta. Falënderoj në veçanti administratorët e vendbanimeve që pa kursyer kohën e tyre, kanë bashkëpunuar me ekzekutivin për të ju dal në ndihmë qytetarëve që të tejkalojmë sa më lehtë këtë gjendje. Po e mbyllim një vit me shumë suksese, duke u shpallur pas rivlerësimit, komuna me performancën me të mirë në nivel vendi, me përfitim të grantit mbi 500 mijë euro, të vlerësuar nga tri Ambasadat me kredibile në vend, po ashtu kemi fituar edhe grantit për mjedis të pastër mbi 540 mijë euro. Të gjitha mjetet e granteve të fituara janë shfrytëzuar në realizim të projekteve për të mirën e komunitetit. Janë asfaltuar dhjetëra kilometra asfalt në lagje, rregullim të rrjetit të kanalizimit në shumicën e vendbanimeve, ndërtimin e kolektorëve për ujëra të zeza, ndriçim publik në shumë lagje të fshatrave, rregullim të trotuareve, ndërtimi i rrjetit elektrik në shumicën e fshatrave, renovimi i QMF-ve e AMF-ve, renovimin e të gjitha shkollave të cilat kanë pasur nevojë të riparohen. Janë krijuar kabinete të informatikës në të gjitha shkollat, funksionalizimin thuaje i të gjitha shkollave

me laboratë, vendosja e kamerave të sigurisë në të gjitha objektet arsimore, pajisja e të gjitha shkollave me inventar, pajisja e të gjitha shkollave me laptop, projektor, tv e tableta të mençur, përkrahja e fermerëve përmes subvencionimit me pajisje të nevojshme për të ju lehtësuar punën, ndarja e serave për fermer, mirëmbajtje të rrugëve gjatë sezonit veror e dimëror, mirëmbajtja e kanalizimeve, mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katër me zhavor, mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimi i hapësirave publike. Ndërtimi i Stadionit Rexhep Rexhepi faza e tretë, ndërtimi i fushave sportive në disa vendbanime, subvencionone në sport, renovimi i stadionit sintetik dhe realizmi i dhjetëra projekteve të tjera të cilat nuk po i përmendi për shkak të kohës.

Samedin Kiqina – Administrator i fshatit Baicë : Në fshatin tonë është punuar bukur shumë mirëpo rruga ku ka pas me u shtrur nuk e di përse nuk është kryer këtë vit. Trotuaret në fshatin Baicë janë punuar jo me cilësi të mirë dhe kisha kërku që punët të cilat kryhen në fshatin tonë të kenë mbikqyrje më të madhe nga organet komunale.

Kryetari Lladrovci : Ju falenderojë juve si administratorë të vendbanimeve për bashkëpunimin që tregoni në realizimin e projekteve por rruga për të cilën ju po thoni është planifikuar për vitin në vijim. Sa i përket çështjes së trotuareve punët ndoshta nuk janë kryer në formën më të mirë të mundshme por ju është dashur me kohë të bëni ankesat e juaja për projektin në fjalë.

Murat Elshani – Administrator i fshatit Gllobar : Në fshatin tonë u punua bukur shumë, por problemi qëndron sepse operatorët nuk po kthejnë në gjendjen e mëparshme në ato projekte që po punohen. Kemi nevojë për ndriqim dhe disa rrugica tjera.

Kryetari Lladrovci : Ka falënderuar Murat Elshanin si administrator i fshatit Gllobar dhe ka treguar se projekti për ndriqim nuk ka mundur të përfshihet vetëm aty ku nuk ka pasur shtylla betoni, pra, ka munguar infrastruktura e nevojshme, kurse aty ku ka pas shtylla betoni është implementu projekti i ndriqimit publik.

Shqiprim Kiqina – Qytetar nga fshati Baicë : Kam bërë kërkesë për rregullimin e rrugës “Fetah Kiqina” në fshatin Baicë, krahas kësaj dua të theksojë se pengesat janë të panevojshme që janë vendosur në rrugë, mirëpo nuk kam marrur ende përgjigje!?

Kryetari Lladrovci ka potencuar se kërkesat shqyrtohen sipas prioriteteve dhe ato dalin pikërisht nga dëgjimet buxhetore dhe bëhen projekte prioritare. Sa i përket pengesave ato do të largohen sepse janë të panevojshme aty ku ka trotuare, kurse aty ku nuk ka trotuare janë më të nevojshme.

Bajram Qallapeku – Administrator i fshatit Tërstenik II : Me punë në fshatin tonë jemi të kënaqur me 95 %, i kemi dy kërkesa : për ujësjellës dhe rregullimin e shenjave të rrugëve me emra të dëshmorëve, të cilat janë dëmtuar dhe larguar nga qytetarët e pandërgjegjshëm.

Kryetari Lladrovci ka treguar edhe njëherë lidhur me pengesat në realizimin e projektit për ujësjellës i cili do të furnizonte 22 vendbanime në Komunën e Drenasit, duke potencuar

edhe njëherë se për shkak të mungesës së gypave të cilët nuk ishin të vendosur në shtrirjen e ujësjellësit dhe lënda është ende në procedura gjyqësore, duke na pamundësuar të ndërhyjmë dhe të furnizojmë vendbanimet me ujë të pijshëm.

Kadri Ajazi – Administrator i fshatit Sankoc : Në fshatin tonë janë bërë punë shumë të mira dhe për këtë jemi mirënjohës, mirëpo është një kërkesë e krahutshme që 3200 metra të kanalizimit në fshatin tonë nuk janë kryer ende dhe po kemi shumë kërkesa nga banorët që të kryhet edhe kjo çështje.

Kryetari Lladrovci ka falënderuar Ajazin si administrator i fshatit Sankoc dhe ka shtuar se pjesa e kanalizimit do të mbetet në shqyrtim për vitin e ardhshëm.

Shemsi Elezi : Mbikëqyrja e projekteve nuk është në nivel sepse operatorët nuk po kryejn siç duhet punën e tyre sidomos kur po kryejn punën po mbetet gjendje e keq në terren. Kjo gjendje është më e theksuar sidomos në Qendër të qytetit ku shumica e projekteve që janë realizuar këtë vit, kryesisht rregullim të kanalizimit dhe elektrifikimit nëntokësor trotualet dhe pjesët e rrugës që janë hapur nuk janë kthyer në gjendjen e mëparshme. Kisha kërkuar që kryetari dhe Komuna ta merre përsipër që herave të tjera të inspektohen më shumë punimet sepse gjendja nuk është e mirë sidomos në qendër të qytetit pas përfundimit të projekteve nga operatorët ekonomik.

Kryetari Lladrovci ka njoftuar zotëri Elezin se do të merren parasysh vërejtjet e tij dhe se ka kërkuar angazhim të përbashkët si shoqëri në identifikimin e problemeve të tilla duke thënë se do kenë përkrahjen e Komunes së Drenasit gjithmonë.

Zekë Kluna – Administrator i fshatit Poklek i Vjetër : Në fshatin tonë është punuar mjaft por ende 4 rrugë kanë mbete pa asfaltu. Kërkesë tjetër është edhe nevoja për ndriqim, trotuar, ura dhe kanalizim.

Kryetari Lladrovci ka falënderuar administratorin Kluna për bashkëpunimin e treguar me vite dhe ka njoftuar se projektet që janë parashtruar nga ai do të kryhen sipas prioriteve të caktuar nga vet banorët.

Procesmbajtësi:

Avdyl Mziu

